



[Data : 19.06.2017]

Për: Bashkimin e operatorëve ekonomikë “2 T” shpk dhe “Be-IS” shpk

Procedura e prokurimit: **“Tender i Hapur”** me objekt : **“Rikonstruksioni rruges "Ura e Çoromit - Zhabiak - Ura e Çëpanit”.**

Përshkrim i shkurtër i kontratës: **“Rikonstruksioni rruges "Ura e Çoromit - Zhabiak - Ura e Çëpanit”.**

Kohëzgjatja: brënda 16 muajve nga data e fillimit te punimeve.

Fondi limit: 261.111.695 (dyqind e gjashtëdhjetë e një milion e njëqind e njëmbëdhjetë mijë e gjashtëqind e nëntëdhjetë e pesë) Lekë pa TVSH.

Fondi i akorduar për vitin 2017 është 52.394.667 (pesëdhjetë e dy milion e treqind e nëntëdhjetë e katër mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e shtatë) Lekë pa tvsh. Pjesa e mbetur është parashikuar për vitin 2018.

Burimi i financimit: Buxheti i Shtetit.

Data e zhvillimit të procedurës së prokurimit: **Datë 24.04.2017.**

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Nuk ka patur.

Njoftojmë se, kanë qënë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara pa tvsh:

NR	SHOQERIA	OFERTA PA TVSH PARA KONTROLLIT ARITMETIK
1	"ALBA KONSTRUKSION" SHPK	161,535,227
2	"BIBA X" SHPK 30% & "ARTI" SHPK 30% & "SENKA" SHPK 30%	161,874,915
3	"MELA" SHPK 26% & "ALB SHPRESA" SHPK 53.9% & "EKSKLUZIV" SHPK 20.1%	165,000,000
4	"LALA" SHPK 48% & "SHANSI INVEST" SHP 40% & "JODY KOMPANY" SHPK 12%	180,258,791
5	"2T" SHPK 50% & "BE IS" SHPK 50%	181,682,963
6	"VELLEZERIT HYSA" SHPK	183,387,595
7	"SHKELQIMI 07" SHPK (80%) & "BOSHNJAKU B" SHPK (10%) & "GRAND KONSTRUKSION" SHPK (10%)	183,500,000
8	"G.P.G" SHPK (95%) & "ENI" shpk (5%)	184,821,851
9	"INTEGRATED TECHNOLOGY SERVICES" SHPK	209,573,979
10	"PE - VLA - KU" SHPK	213,810,384
11	"4AM" SHPK	219,069,629
12	"VARAKU E" SHPK	NUK KA PARAQITUR OFERTE

Pas vleresimit të dokumentacionit të paraqitur (duke përfshirë edhe rivleresimet) komisioni me unanimitet vendosi të skualifikoje shoqerite:

- 1. Te skualifikoje bashkimin e Operatoreve Ekonomike “Biba X” shpk (30%), “Arti” shpk (40%) dhe “Senka” shpk (30%) pasi:**

Shoqeria “Biba X” shpk nuk ploteson kerkesen 2.a te Kerkesave te Pergjithshme per Kualifikim lidhur me shlyerjen e detyrimeve fiskale pasi sipas vertetimit te paraqitur rezulton se ka detyrime tatimore ne shumen 10.101.319 leke per te cilat nuk eshte ankimuar ne gjykate.

Duke qene se kjo eshte nje e mete thelbesore, komisioni vendosi te mos procedoje me tej me shqyrtimin e dokumentacionit te mbetur per kete bashkim shoqerish.

2. Te skualifikoje bashkimin e Operatoreve Ekonomike “Mela” shpk (26%), “Alb Shpresa” shpk (53.9%) dhe “Ekskluziv” shpk (20.1%) pasi:

Shoqeria “Alb Shpresa” shpk nuk ploteson kerkesen 2.3.1 per kualifikim lidhur me punet e ngjashme pasi ka paraqitur 2 pune si pune te ngjashme:

“Rikonstruksioni i rruges Shengjin Kune”. Vlera me tvsh e punes sipas formularit te vleresimit eshte 339.474.230 leke me tvsh ose 282.895.191 leke pa tvsh. Shoqeria “Albshpresa” shpk ne total ka realizuar 40% ose 113.158.076 leke nga 130.555.847 leke qe duhet te kishte realizuar me nje pune te vetme si ortaku me % me te madhe ne bashkimin e shoqerive.

“Ndertim ura e Matit Burrel”. Vlera me tvsh e punes sipas formularit te vleresimit eshte 209.132.071 leke me tvsh ose 174.276.725 leke pa tvsh. albshpresa ne total ka realizuar 51% ose 88.881.130 leke qe duhet te kishte realizuar me nje pune te vetme si ortaku me % me te madhe ne bashkimin e shoqerive.

Vlera e realizuar me te dy punet eshte 202.039.206 leke pa tvsh nga 281.478.407 leke qe duhet te ishte sipas perqindjes se puneve qe ka marre persiper.

Duke qene se kjo eshte nje e mete thelbesore, komisioni vendosi te mos procedoje me tej me shqyrtimin e dokumentacionit te mbetur per kete bashkim shoqerish.

3. Te skualifikoje bashkimin e Operatoreve Ekonomike “Lala” shpk (48%), “Shansi Invest” shpk (40%) dhe “Jody Kompany” shpk (12%) pasi:

Shoqeria “Lala” shpk nuk ploteson piken 2.3.1 te Kerkesave te Vecanta per Kualifikim lidhur me punet e ngjashme pasi objekti i ngjashem “Infrastruktura e qytetit Krume” me vlere te realizuar ne tre vitet e fundit (referuar faturave tatimore) 18.373.046 leke pa tvsh nuk eshte i mjaftueshem per te plotesuar kushtin. Si pjesetar i bashkimit me vleren me te madhe (48%) duhet te kishte paraqitur nje objekt me vlere jo me pak se 130.555.848 leke pa tvsh. Objektet e tjera te deklaruar jane ujesjellesa, dhe si te tille nuk mund te konsiderohen si pune te ngjashme.

Shoqeria “Jody Kompany” shpk nuk ploteson kerkesen 2.3.3 per kualifikim lidhur me stafin pasi ka marre persiper punime shtresash ne rruge dhe nuk ka paraqitur dokumentacion per ing ndertimi me profil transport ne perputhje me kerkesen per kualifikim.

4. Te skualifikoje shoqerine “Alba Konstruksion” per arsye se:

Shoqeria “Alba Konstruksion” shpk nuk ploteson pikën 2.3.3 dhe 2.3.4 te Kerkesave te Vecanta per Kualifikim, pasi nje pjese e stafi teknik te deklaruar eshte angazhuar në kontratën “Rikualifikim

Urban i Bashkisë Pukë” per te cilen shoqeria “Alba Konstruksion” shpk eshte shpallur fituese pranë Autoritetit Kontraktor Fondi Shqiptar I Zhvillimit.

Shoqeria “Alba Konstruksion” shpk nuk ploteson pikën 2.3.7 dhe 2.3.8 te Kerkesave te Veçanta, pasi nje pjese e mjeteve te deklaruar ne procedure qe shqyrtohet janë angazhuar në kontratën “Rikualifikim Urban i Bashkisë Pukë” per te cilen shoqeria “Alba Konstruksion” shpk eshte shpallur fituese pranë Autoritetit Kontraktor Fondi Shqiptar I Zhvillimit.

5. Te skualifikoje bashkimin e Operatoreve Ekonomike “Shkelqimi 07” shpk (80%), “Boshnjaku B” shpk (10%) dhe “Grand Konstruksion” shpk (10%) pasi:

Shoqeria “Shkelqimi 07” shpk nuk ploteson kerkesen 2.3.2 per kualifikim lidhur me numrin e nevojshem te punonjesve pasi numri mesatar per periudhen e kerkuar rezulton te jete 72 persona nga 82 qe duhet te kishte sipas % se puneve qe ka marre persiper (80%).

Duke qene se kjo eshte nje e mete thelbesore, komisioni vendosi te mos procedoje me tej me shqyrtimin e dokumentacionit te mbetur per kete bashkim shoqerish.

6. Te skualifikoje bashkimin e Operatoreve Ekonomike “GPG” shpk (95%) dhe “ENI” shpk (5%) pasi:

Shoqeria “GPG” shpk nuk ploteson kerkesen 2.2.4 per kualifikim lidhur me taksat vendore pasi nuk ka paraqitur vertetim per shlyerjen e detyrimeve vendore ne Korce, ku ushtron aktivitet qysh prej vitit 2016, referuar tabelës se deklarimit te puneve ne proces.

Shoqeria “GPG” shpk nuk ploteson kerkesen 2.3.3 per kualifikim lidhur me stafin pasi nuk ka paraqitur dokumentacion per ing ndertimi me profil transport, ing elektrik, ing mekanik, ing topograf.

Shoqeria “Eni” shpk nuk ploteson kerkesen 2.3.5 per kualifikim lidhur me punesimin e mjekut, pasi nuk ka paraqitur dokumentacion per kete qellim.

7. Te skualifikoje bashkimin e Operatoreve Ekonomike “Integrated Technology Services” shpk (85%) dhe “Hastoci” shpk (15%) pasi:

Shoqeria “Integrated Technology Services” shpk nuk ploteson kerkesen 2.3.3 per kualifikim lidhur me stafin pasi nuk ka paraqitur dokumentacion per ing ndertimi me profil transport dhe ing hidroteknik.

Shoqeria “Integrated Technology Services” shpk nuk ploteson kerkesen 2.3.6 per kualifikim lidhur me pikat e nevojshme te licenses pasi nuk disponon pikan e licenses N.P – 4. D Rrugë, autostrada, mbikalime, hekurudha, tramvai, metro, pista aeroportuale (e ka A) si dhe N.P – 5. B Punime nentokesore, vepra arti. (e ka A).

8. Te skualifikoje shoqerine “Pe Vla Ku” shpk pasi:

Dokumentat e paraqitura nga Kosova jane pa vulen apostile.

Nuk ploteson kerkesen 2.3.3 per kualifikim lidhur me stafin pasi nuk ka paraqitur dokumentacion per ing mjedisi. Kimisti per te cilin ka paraqitur dokumentacion nuk mund te zevendesoje inxhinierin e mjedisit, per me teper qe nuk ka asnje deshmi te posacme nga Ministria e Mjedisit.

Nuk ploteson kërkesen 2.3.4 për kualifikim lidhur me deklarin për mosangazhimin e stafit, pasi nuk ka paraqitur deklaratën e kërkuar.

9. Te skualifikoje shoqerine “Varaku E” shpk pasi nuk ka paraqitur oferte.

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë **bashkimin e operatorëve ekonomikë “2 T” shpk dhe “Be-IS” shpk** se oferta e paraqitur, me vlerë 181,682,963 **(njqind e tetedhjetë e një milion e gjashtëqind e njetzet e tete mije e nenteqind e gjashtedhjetë e tre)** lekë pa TVSH është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë **Autoritetit Kontraktor:**

- **Fondi Shqiptar i Zhvillimit**
- **Rr. “Sami Frashëri”, Nr. 10, Tirana, Albania**
- **Phone: 00355 4 2 235 597/8 (int.151)**
- **Fax: 00355 4 2 234 885**

sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda pesë ditëve nga data e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj (nëse është kërkuar) dhe kontrata do t’i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit përfundimtar është bërë në datë **06.06.2017**.

Ne datën 12.05.2017 paraqiti ankese për vleresimin shoqeria “Biba X” shpk. Ankese ju kthye përgjigje ne datën 15.05.2017 duke e refuzuar atë.

Ne datën 15.05.2017 paraqiti ankese për vleresimin shoqeria “Vellezerit Hysa” shpk. Ankese ju kthye përgjigje ne datën 22.05.2017 duke e pranuar atë.

Ne datën 24.05.2017 shoqeria “Biba X” shpk paraqiti ankim ne KPP.

Ne datën 25.05.2017 paraqiti ankese për vleresimin shoqeria shoqeria “Lala” shpk.

Ne datën 25.05.2017 paraqiti ankese për vleresimin shoqeria shoqeria “2T” shpk.

Ne datën 29.05.2017 paraqiti ankese për vleresimin shoqeria shoqeria “Alba Konstruktion” shpk.

Ne datën 30.05.2017 paraqiti ankese për vleresimin shoqeria shoqeria “4AM” shpk.

Ne datën 05.06.2017 u publikua vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik me të cilin refuzohet ankimi i paraqitur nga shoqeria “Biba X” shpk dhe lejohet autoriteti kontraktor të vazhdojë procedurat.

Ne daten 06.06.2017 ju kthye pergjigje shoqerise “Lala” shpk duke e refuzuar ate.

Ne daten 06.06.2017 ju kthye pergjigje shoqerise “2T” shpk duke e pranuar ate.

Ne daten 06.06.2017 ju kthye pergjigje shoqerise “4AM” shpk duke e refuzuar ate.

Ne daten 06.06.2017 ju kthye pergjigje shoqerise “Alba Konstruksion” shpk duke e refuzuar ate.

Në datën 08.06.2017, shoqëria 4 AM sh.p.k paraqiti ankim prane Komisionit te Prokurimit Publik.
Ne daten 13.06.2017 u publikua vendimi i Komisionit te Prokurimit Publik (K.P.P 415/2017) me te cilin refuzohet ankimi i paraqitur nga shoqeria “4 AM” shpk dhe lejohet autoriteti kontraktor te vazhdoje procedurat.

